



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 160/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur ndaj Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Raundin e II (dytë) për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 31.05.2012, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 30.05.2012, nga subjekti politik LDK, në të cilën pretendohet se në Qendrat e Votimit (QV) mobil 25/03/01, QV2516D/03D, QV2524D/03D dhe QV2504D/06D, janë evituar disa parregullsi, sepse 77 zarfe me fletëvotime, prej tyre 62 të rregullta kurse 15 të pa rregullta. Prej zarfeve të rregullta sipas parashtruesit të ankesës 49 fletëvotime janë të rregullta, ku kandidati i LDK-së ka 24 vota kurse kandidati i PDK-së 25 vota. Prej 62 votave 13 vota janë të pavlefshme ndërsa prej 3 votave të pavlefshme 2 fletëvotime janë të zbrazëta, 2 fletëvotime janë votuar 2 kandidatë, ndërsa 8 fletëvotime janë të raundit të parë. Parashtruesi i ankesës kërkon anulimin e fletëvotimeve me kusht në QV e lartpërmendura.

PZAP pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës pretendon ka pasur parregullsi në numërimin e votave për QV-të e lartpërmendura. PZAP-i, konstatoi se ankesa nuk i përmbush kriteret e parapara në nenin 3 paragrafi 6 pika “b” e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ngase në ankesë nuk është bërë një përshkrim i hollësishëm duke përfshirë datën, kohën e shkeljes së supozuar. Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës për ti bërë pretendimet e tij më bindëse ashtu që eventualisht PZAP-i të merr

ndonjë vendim tjetër për rastin në fjalë, andaj konform nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 105 paragrafi 1, lidhur me nenin 115.1 të LZP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 160/2012 më datën 31.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

